



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr 1398 AKTI

VENDIM
“PER VLEFTESIM LEJIM PERGJIMI”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere prej:

Gjyqtare: ELONA GJOKA

asistuar nga sekretare gjyqesore Suela Arapi (Murataj), sot me date 09.10.2012, mori ne shqyrtim materialin procedues qe i perket:

KERKUES: PROKURORIA prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me prokuror Xhelian Seferi.

OBJEKTI: Caktim mase sigurimi pasuror “sekuestro preventive”

BAZA LIGJORE: Neni 274 i K.Pr.Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi kerkesen e Prokurorit dhe dokumentacionin e paraqitur

VEREN:

Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane, ne date 08/05/2012, ka regjistruar procedimin penal nr. 2211, per vepren penale te “Vjedhje” dhe “Shperdorim detyre”, parashikuar nga nenet 134 dhe 248 i Kodit Penal ne ngarkim te personave nen hetim (.....) dhe (.....). Nga tersia e provave te grumbulluara ne lidhje me kete procedim penal rezulton se,

Me date 02.03.2012 Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane ka rregjistruar kallezimin penal nr.1599 te vitit 2012. Kallzuesi Shoqeria Fushe Kruje Cement Factory shpk., sqaron ne kallezimin e saj se shtetasit (.....) me profesion avokat dhe shtetasi (.....) me detyre permbarues privat, ne bashkepunim me njeri tjetrin kane perfituar ne menyre te padrejte prej tij.

Para disa vitesh, Shoqeria Fushe Kruje Cement Factory shpk. Ka patur nje konflikt gjyqesor me dy shtetas te huaj (.....) dhe (.....) (.....). Ky konflikt rridhte nga nje kontrate pune qe dy shtetasit e mesiperme kishin me Shoqerine Fushe Kruje Cement Factory shpk.Per perfaqesimin e tyre keta shtetas kishin caktuar Av (.....), anetar i dhomes se avokatise Tirane dhe nje person tjetere i quajtur (.....).Kjo ne baze te prokures me nr. 3146 Rep. dhe nr. 900 Kol.,date 20.07.2009 te redaktuar nga notere Aishe Ahmetaga.

Gjate zhvillimit te gjykimit ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, palet bien dakort q etazgjidhin ceshtjen me marreveshje. Per kete Shoqeria Fushe Krujë Cement Factory shpk. Pranon ti paguaje paditesave (.....) dhe (.....) Shumen per te cilen ato kishin rene dakort. Ne kete moment paditesat I bejne me dijene avokatit (.....) qe nuk duhet te vijonte procedurat ne lidhje me zgjidhjen e ceshtjes, pasi ata e konsideronin te zgjidhur ate,

Gjykata ka miratuar marreveshjen e bere midis Shoqerise Fushe Krujë Cement Factory shpk. dhe shtetasve (.....) dhe (.....) dhe me vendimin nr.322, date 14.07.2010 ka vendosur te pranoje padine dhe te detyroje palen e paditur te paguaje paditesave shumen totale 263522 dollare amerikane). Ky vendim eshte lene ne fuqi nga Gjykata e Apelit Tirane me vendimin nr.1558 date 30.06.2011.

Ne kushtet kur Gjykimi ne Apel ishte zhvilluar ne mungese, pasi Shoqeria Fushe Krujë Cement Factory shpk. E konsideronte ceshtjen e mbyllur, me date 15.07.2011 nga ana e zyres permbarimore e perfaqesuar nga permbarues privat (.....), I eshte drejtuar Bankave te nivelit te dyte me Urdher per Vendosje e Sekuestros Konservative nr.714 prot. Dhe nr.119 Regj.

Shoqeria Fushe Krujë Cement Factory shpk. mori nderkohe disa procedura te tjera ligjore ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, duke marre nje mase sigurie pezullimi ne kete Gjykate.

Ne shtator 2011 Gjykata e larte celi punen dhe ajo vendosi pezullimin e vendimit. Po keshtu i them klientit qe te lidhen me dy paditesit, ku ata duhet te komunikojne me perfaqesuesit e tyre (.....) dhe (.....) per tu komunikuar se “Nuk kane asnje pretendim ndaj nesh dhe se nuk duan asnje shume ndaj nesh. Te njejten deklarim te na e dergoje dhe ne”. Ata ishin shume bashkepunues, duke thene “Jemi te gatshem te nenshkruajme cdo dokument qe doni, pasi nuk kemi dijene te procesit gjyqësor, ato jane pune vetem te avokateve”

Ne keto kushte avokatja Adeljda Fortuzi e caktuar avokate prej tyre, komunikonte me palet. Ne keto rrethana kishim menduar se avokatet e caktuar me prkure prej tyre kishin dijene per qendrimin qe mbanin. Me tej kallzuesi ka kerkuar nje dokument zyrtar formal qe eshte “Revokimi formal i prokures dhe autorizimin per avokate (.....) pushimin e ekzekutimit”. Ne prokuren e (.....)t ai kishte komptenece qe parate te kerkonte kalimin e parave ne llogarine e (.....) dhe (.....) ne banke Prokredit apo ne institucion tjetër bankar. Vine tekstet e prokurave te noterizuara dhe legalizuara. Ne kete kohe del per gjykim ankimi ne Apel i bere nga (.....)a kunder vendimit te gjykates se Krujes per masen provizore. Ne Gjykatën e apelit Tirane date 07.02.2011 me gjyqtar Artur Kalaja , ne kete seance ne kerkimet paraprake perfaqesuesja e Cement Factory i ka komunikuar gjykates, se zoti (.....)a nuk ka akt perfaqesimi pasi prokura e tij eshte revokuar. Artan Hoxha mer kopjet e akteve dhe deklaroi se “me duhet kohe te flas me klientet e mi.”Gjykata e shtyu gjykimin per date 28.02.2012., meqenese pala nuk paraqiti kjo gjykate kete dit vendos pushimin e gjykimit.

Me date 07.02.2012 (.....) i dergon nje E-mail te dy klienteve. Prej tyre merret konfirmimi se: “Ju keni vazhduar nje gjyq pa e ditur ne. Ne se kemi thene qe ne ate kohe se nuk duhet te vadhoni kete gjyq, e ju nuk na keni informuar. Konfirmojme se kemi leshuar revokimin e prokures”.Perfaqesuesja vazhdonte te bente komunikimet me palet per te penguar ekzekutimin e vendimit te gjykates.

Gjykata e Apelit ka marre ne shqyrtim ceshtjen e themelemit mbi bazen e ankimit te bere nga shoqeria, ku avokat ka qene nje koleg tjetër, duke theksuar se Mos marreveshja ishte zgjidhur. Ne korrik 2011 Gjykata e Apelit ka lene ne fuqi vendimin e gjykates se shkalles se pare kruje ne mungese pasi pala e paditur Shoqeria Cement shpk. nuk u perfaqesua.

Avokati (.....) ka vazhduar te veproje si perfaqesues i pales se vet ne kundershtrim me vullnetin e pales se tij edhe pasi ka marre dijëni formal te revokimit te prokures me date 07.02.2012, pasi kete date i eshte komunikuar duke u bazuar ne process verbalin gjyqesor. Avokati nuk ka asnje te drejte nga vendimi gjyqesor qe te veproje kunder vullnetit te pales. Keto te drejta i ka vetem (.....) dhe (.....) ku perfaqesues tashme eshte (.....) qe nga data e revokimit te prokures. Persa i takon perpmbaruesi ka marre njoftim per kete fakt ku palet ku palet kerkonin pushimin e ekzkeutimit, kerkesa e bere nga pala kreditoreme perfaqesues (.....). Ai nuk ka kompetence te beje zbatimin e vendimeve gjyqesore, por vetem me kerkesen e kreditorit. Ai eshte njoftuar me te gjitha llojet e komunikimit, por ai shmangeshe me aresyetime. Per kete person kemi bere ankim tek Ministrin e Drejtesise e cila e ka gjetur me shkelje.

Rezulton se me date 21.02.2012 shtetesja (.....) ka takuar permbaruesin gjyqesor (.....), ne precence te (.....) dhe (.....), ne ambjentet e Bankes Procredit.(.....) nuk ka pranuar te flase me to, duke I thene qe te shkonte ta takonte ne zyre. Pasi ka shkuar ne zyren e (.....)t, shtetesja (.....) nuk e ka gjetur aty. Ne kete menyre shtetesja (.....) i ka lene nje shenim ne deren e zyres se permbaruesit, duke e lajmeruar se “Kerkoj te dorezohet dokumentat e revokimit te prokures te avokat (.....).

Te gjitha veprimet beheshin me kerkesen e (.....)t, i cili nuk duhet te vazhdonte. Me date 21.02.2012 eshte bere nje tjetër padi ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane per pezullim dhe ankim te veprimeve permbarimore. (.....) eshte paraqitur ne gjyq. Me date 24.02.2012 gjyqtarja Enkela Bajo ka marre vendim pezullimi. Me date 21.02.2012 dhe me date 23.02.2012 behet kalimi i shumave nga shoqeria Cement Factory shpk. Tek (.....) dhe nga ky tek (.....).

Eshte zhvilluar korrespondenca me Banken ProCredit. Jane marre dokumenta qe vertetojne veprimet bankare te personave te mesiperm.

Eshte e nevojshme te verifikohet dijënia e personit nen hetim per seancen gjyqesore te dates 24.02.2012 ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Me date 25.09.2012 i eshte kerkuar Bankes ProCredit per te marre kopje te depozites bankare dhe transaksionet e kryera nga shtetasi (.....).

Ne pergjigjen e ardhur nga Banka ProCredit sha me nr.Prot. OP17363/1, date 04.10.2012 rezulton se shtetasi (.....) ka llogari rrjedhese prane kesaj banke me IBAN AL (.....)

Gjithashtu rezulton se nga kjo llogari rrjedhese e personit nen hetim (.....) jane kryer disa transfertat bankare. Konkretisht me date 23.02.2012 kjo llogari eshte kredituar ne shumen 25.897.520 leke nga permbaruesi gjyqesor person nen hetim (.....). Me date 23.02.2012 me COD Tr.(.....) kjo llogari eshte debituar ne favor te shtetasit (.....) ne shumen (.....) leke. Kjo shume eshte ne ekzekutim te nje vendimi gjyqesor, konkretisht te vendimit nr. 322, date 14.07.2010 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kruje me pale paditese shtetasit (.....) (.....) dhe pale te paditur Shoqeria Fushe Kruje Cement Factory shpk. Ne baze te vendimit te mesiperm te ekzekutuar nga Permbaruesi Gjyqesor ne favor te personit nen hetim (.....). Ky i fundit kete shume duhet te kishte kaluar ne favor te te shtetasve (.....) (.....) dhe (.....) (.....) te cilet siaps tij i perfaqesonte ne

grykim. Ne kundërshtim me këtë vendim ky shtetas ka kaluar shumën e mesipërme në favor të djalit të tij shtetasit (.....).

Prandaj sa më sipër është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimit kaktimi i masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventivë” të parashikuar nga neni 274 i K.Pr.Penalë, ndaj llogaritë së shtetasit (.....) në bankën ProCredit sh.a. Tiranë. Kjo masë është e domosdoshme pasi ka rrezik që disponimi i lire të shumës prej (.....) lekë nga ky shtetas mund të rëndojë apo zgjasë pasojat e veprës penale. Shuma e mesipërme ka patur si destinacion shtetasin (.....) dhe (.....) (.....). Kjo për shkakun se sic ka rezultuar gjatë hetimit, këtë shumë parash e ka derdhur në llogarinë e Përmbaruesit gjyqësor privat, Shoqëria Fushe Krujë Cement Factory shpk., e të përfaqësuar nga personi nën hetim (.....).

Në këtë rrethana nga ana e Prokurorisë kërkohet të caktohet masa e sigurimit pasuror “Sekuestro preventivë”, të parashikuar nga neni 274 i K.Pr.Penalë, ndaj llogaritë të shtetasit (.....) në Bankën ProCredit deri në vlerën (.....) lekë.

Gjykata çmon që kjo kërkesë është e bazuar në ligj, neni 174 i K.Pr.Penalë, dhe si e tillë duhet pranuar.

PER KETO ARSYE:

Gjykata në bazë të nenëve 274 i K.Pr.Penalë

VENDOSI:

1. Të caktohet masa e sigurimit pasuror “Sekuestro preventivë”, të parashikuar nga neni 274 i K.Pr.Penalë, ndaj llogaritë të shtetasit (.....) (.....) në Bankën ProCredit deri në vlerën (.....) lekë.
Urdhërohet Policia Gjyqësore për zbatimin e këtij vendimi.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve në Gjykatën e Apelit Tiranë.
3. U shpall sot, në Tiranë, më 09.10.2012.

SEKRETARE
SUELA ARAPI (MURATAJ)

GJYQTARE
ELONA GJOKA